

Roto Recycling SH.P.K.

RAPORT

I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS

Depo e grumbullimit të letrës dhe plastikës

Obiliq



Roto Recycling SH.P.K.

RAPORT
I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS

Depo e grumbullimit të letrës dhe plastikës

Obiliq

Investitori:

Roto Recycling SH.P.K.

Hartuesi i raportit:

Ibush Luzha, i licencuar për VNM _____

Kontaktet:

Investitori: Roto Recycling SH.P.K.	Hartuesi Raportit: Ibush Luzha ibushluzha@hotmail.com
Emri Mbiemri: Mentor Ramadani Email: rotorecyclingks@gmail.com	Ibush Luzha ibushluzha@hotmail.com
Telefoni: +383 49 657 600	Telefoni: 044 124 889

Vlera investive:	45,000.00 € (Katërdhjetë e pesëmijë euro e zero cent)
------------------	---



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government
Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Zivotne Sredine Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment Spatial Planing and Infrstructure

Në bazë të nenit 16 paragrafit 1 të Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr.03L/214 dhe Udhëzimi Administrativ për Licencim të Hartuesëve të Raporteve për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr.10/2017, Ministri i MMPHI lëshon:

Nr. i licencës: 84/18

LICENCË

z. Ibush LUZHA

Doktor i shkencave të Gjeologjisë dhe Minierave

Licencohet si person fizik për hartimin e raporteve të VNM-ës

Data e vlefshmërisë:
27. 05. 2022 — 26.05.2027
Prishtinë



PËRMBAJTJA:

1. HYRJE	7
2. BAZA LIGJORE PER HARTIMIN E RAPORTIT	7
2.1. Rregullativa ligjore	8
2.2. Metodologjia e punës	9
3. PËRSHKRIMI I LOKACIONIT DHE MJEDISIT	10
3.1. Potencialet ekzistuese	10
3.2. Pozita gjeografike e lokacionit.....	11
3.3. Popullsia dhe vendbanimet	13
3.4. Infrastruktura ekzistuese	13
3.5. Kushtet klimatike	14
3.6. Gjendja Hidrologjike.....	15
3.7. Flora dhe Fauna.....	15
3.8. Karakteristikat sizmike	16
3.9. Efektet vizuale (peizazhi).....	17
3.10. Ajri	17
3.11. Uji.....	17
4. PËRSHKRIMI I DEPOS PËR GRUMBULLIMIN LETRËS DHE PLASTIKËS.....	18
4.1 Përshkrimi i procesit të grumbullimit të letrës dhe plastikës	18
4.1.1. Grumbullimi i letrës	18
4.2.2. Grumbullimi i plastikës.....	20
4.2 Përshkrimi i pajisjeve.....	23
4.3. Platoja.....	26
4.4. Rezervarët	27
4.7. Komponentët dalëse në procesin teknologjik	29
5. VLERËSIMI I NDIKIMIT NË MJEDIS	29
5.1. Ndotja e ajrit.....	30
5.2. Ndotja e ujit.....	31
5.3. Ndotja e tokës.....	31
5.4. Zhurma	32
5.5. Ndikimet në florë dhe faunë.....	32
5.6. Ndikimi në mjedis në rastet aksidentale	32
6. MARRJA E MASAVE PËR PARANDALIMIN DHE ZVOGËLIMIN E NDIKIMEVE ..	33
6.1. Masat e ndërmarra për eliminimi i ndikimeve të dëmshme në mjedis	33
6.2. Masat mbrojtëse të ujërave	33
6.3. Masat për mbrojtjen e ajrit	35
6.4. Masat për mbrojtjen e tokës	36

6.5. Masat për mbrojtje kundër zjarri.....	36
6.6. Masat e mbrojtjes nga zhurma.....	37
6.7. Ndikimet në raste të aksidenteve mjedisore - në rast zjarrit	37
6.8. Masat për mbrojtjen e florës dhe faunës	38
6.9. Masat e marra për mbrojtjen nga rreziqet aksidentale	38
7. PROGRAMI I MONITORIMIT	39
8. RAPORTIMI.....	40
9. MARRJA E MASAVE REHABILITUESE PAS PËRFUNDIMIT TË AKTIVITETIT GRUMBULLUES.....	40
10. KONKLUDIM	41
11. PËRFUNDIMI	42

1. HYRJE

Për hartimin e raportit të VNM-së mbi ndikimin në mjedis për Depon e grumbullimit të letrës dhe plastikës në kompaninë Roto Recycling SH.P.K. në Obiliq nevojitet të bëhet një analizë e ndikimeve të mundshme në mjedis ku përmes këtij raporti të VNM-së do të përkufizohen të gjitha ndikimet relevante që mund të paraqiten në hapësirat e Depos për grumbullimin e letrës dhe plastikës duke marr parasysh mjedisin e gjerë.

Vlerësimi i ndikimit në mjedisin për investimet kapitale si në vendet e zhvilluara të Evropës e tani edhe te ne është obligim dhe është bërë praktikë e përhershme dhe paraqet një nga instrumentet shumë efikase në mbrojtjen e mjedisit.

Në Kosovë vlerësimi i ndikimit në mjedis (VNM) ka filluar të zbatohet pas miratimit të ligjit për mbrojtjen e mjedisit 2003/09, ku qartë janë të precizuara obligimet e investitorit në aspektin e mbrojtjes së mjedisit gjatë investimeve kapitale.

Hartimi i raportit për vlerësimin e ndikimit në mjedis është bërë me qëllim që në mënyrë transparente të paraqitet ndikimi në mjedis i Depos së grumbullimit të letrës dhe plastikës me infrastrukturën përcjellëse, me të gjitha aktivitetet punuese në mënyrë që të mundësohet ruajtja e mjedisit.

Ky vlerësim i ndikimit në mjedis i Depos së grumbullimit të letrës dhe plastikës me infrastrukturën përcjellëse, është punuar duke u bazuar në projektin e ndërtimit, karakteristikat e lokacionit, gjendjen ekzistuese të mjedisit rreth Depos si dhe dokumenteve teknike ekzistuese.

Detyra e përgatitjes së këtij raporti për Depon e grumbullimit të letrës dhe plastikës me infrastrukturën përcjellëse, kryesisht ka për qëllim identifikimin e burimeve të ndotjes, vlerësimin e ndikimit të tyre në mjedis si dhe propozimin e veprimeve për parandalimin apo së paku zvogëlimin e vlerave të ndotjes në kufijtë e lejuar gjatë:

- Fazës së aktiviteteve punuese;
- Fazës së përfundimit të aktiviteteve punuese.

Të gjitha konstatimet dhe rekomandimet për mbrojtjen e mjedisit që dalin nga ky raport, duhet të respektohen gjatë fazës së procesit të punës të Depos për grumbullimin e letrës dhe plastikës.

2. BAZA LIGJORE PER HARTIMIN E RAPORTIT

Me rastin e hartimit të Raportit janë marrë për bazë ndikimet në mjedis dhe aplikimi i masave për zvogëlimin e ndikimeve gjatë fazës së realizimit të aktiviteteve punuese të Depos së

grumbullimit të letrës dhe plastikës me infrastrukturën përcjellëse dhe pas përfundimit të veprimtarive punuese të Depos.

Analiza përfshin projeksionin e masave mbrojtëse për mjedisin me rastin e ndonjë aksidenti mjedisor gjatë funksionimit në vazhdim të Depos së grumbullimit të letrës dhe plastikës me infrastrukturën përcjellëse, ne Obiliq edhe atë:

- Identifikimin e burimit që rrezikon mjedisin
- Vlerësimin e ndikimit në mjedis
- Propozimin e masave themelore për minimizimin apo zvogëlimin e ndikimeve negative gjer në kufijtë e lejuar.

2.1. Rregullativa ligjore

a) Dokumentacioni normativ

Si bazë themelore për punimin e Raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis i Depos së grumbullimit të letrës dhe plastikës me infrastrukturën përcjellëse në Obiliq, me infrastrukturë përcjellëse janë shfrytëzuar:

a) Dokumentacioni normativ

1. Ligji Nr.03/L-025 për mbrojtjen e mjedisit;
2. Ligji Nr. 08/L-181 për vlerësimin e ndikimit në mjedis;
3. Ligji Nr. 08/L-071 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-060 për mbeturina, 01.09.2022;
4. Ligji Nr. 04/L-174 për planifikimin hapësinor;
5. Ligji Nr. 04/L – 110 për ndërtim;
6. Ligji Nr. 08/L-112 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 02/L-26 për token bujqësore, 24.08.2022;
7. Ligji Nr. 03/L-233 për mbrojtjen e natyrës;
8. Ligji Nr. 04/L-147 për ujërat e Kosovës;
9. Ligji Nr. 08/L-116 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-197 për kimikate, 05.09.2022;
10. Ligji Nr. 08/L-025 për mbrojtjen e ajrit nga ndotja;
11. Ligji Nr. 02/L-102 për mbrojtjen nga zhurma;
12. Ligji Nr. 04/L-012 për mbrojtje nga zjarri;
13. Udhëzim Administrativ (MMPHI) Nr. 02/2022 për kushtet, mënyrat, parametrat dhe vlerat kufizuese të shkarkimit të ujërave të ndotura në rrjetin e kanalizimit publik dhe në trupin ujor;
14. Udhëzim administrativ (QRK) Nr. 07/2021 për rregullat dhe normat e shkarkimeve në ajër nga burimet e palëvizshme të ndotjes;
15. Udhëzim Administrativ (QRK) Nr.08/2017 për menaxhimin e deponive të mbeturinave

16. Udhëzim Administrativ MMPH - Nr. 27/2014 për menaxhimin e mbeturinave nga ambalazhet dhe paketimet;
17. Udhëzim administrativ (QRK) Nr. 11/2018 për vlerat kufitare të emisioneve të materieve ndotëse në tokë;
18. Udhëzim Administrativ MMPH-Nr. 04 /2018 për pengimin e aksidenteve të mëdha ku përfshihen substancat e rrezikshme

b) Dokumentacioni teknik

- Projekti kryesor i Depos së grumbullimit të letrës dhe plastikës me infrastrukturën përcjellëse, ne Obiliq;
- Plani i situacionit;
- Kopja e planit të parcelës;
- Certifikata mbi të drejtat e pronës;
- Certifikata e regjistrimit të biznesit;
- Kushtet e përkohshme urbanistiko-teknike, pëlqimi komunal;

Duke marrë parasysh faktin se një pjesë të madhe e specifikave mjedisore nuk janë përfshirë në kuadër të rregullativës së sipërshtuar për nevojat e hartimit të këtij elaborati është shfrytëzuar edhe rregullativa relevante ndërkombëtare si dhe direktivat përkatëse për mjedis dhe ndikimet në mjedis.

2.2. Metodologjia e punës

a) Metodologjia e punës me të cilat bëhet vlerësimi i ndikimit në mjedis i Depos së grumbullimit të letrës dhe plastikës me infrastrukturën përcjellëse në Obiliq të Komunës së Obiliqit, është kryer në disa faza edhe atë:

- Burimet themelore të ndikimeve në mjedis;
- Popullata ekzistuese me karakteristikat demografike;
- Karakteristikat e dheut, topografia dhe peizazhi në lokacionin e Depos;
- Klima e lokacionit me të dhënat meteorologjike;
- Cilësia i ajrit dhe ujit në lokacionin më të gjerë;
- Bota bimore dhe shtazore në terrenin e analizuar.

b) Vlerësimi i ndikimeve sipas këtyre kualifikimeve

- Madhësia dhe lloji i ndotjes;
- Karakteristikat dhe dominimi i materialit ndotës;
- Gjendja e mjedisit në terrenin e analizuar;
- Vlerësimi i shpërndarjes në hapësirë i materies ndotëse.

c) Analiza e rrezikimit të:

- Njeriut;
- Vlerave materiale;
- Vlerave natyrore.

d) Përcaktimi i masave mbrojtëse sipas rezultateve të arritura mbi vlerësimin e ndikimit në mjedis në lokacionin e Depos së grumbullimit të letrës dhe plastikës me infrastrukturën përcjellëse. Pjesa më e rëndësishme e analizës së këtij raporti i kushtohet kvantifikimit dhe vlerësimit të gjendjes ekzistuese. Hulumtimi karakterizohet me faktin se kemi të bëjmë me vendin që nuk ka të bëjë me ndonjë potencial të shprehur ekologjik. Rezultati i këtyre analizave paraqet një dëshmi mbi gjendjen aktuale të mjedisit në këtë lokacion.

3. PËRSHKRIMI I LOKACIONIT DHE MJEDISIT

Depo e grumbullimit të letrës dhe plastikës me infrastrukturën përcjellëse e Kompanisë Roto Recycling SH.P.K., gjendet në dalje të Obiliqit në drejtim të Prishtinës, në anën djathtë të rrugës ku janë ndërtuar dhe janë duke u ndërtuar objekte afariste, siç janë: pompa të derivateve, markete, objekte tregtare dhe industriale, depo të materialeve ndërtimore etj.

Kompleksin i Depos e përbëjnë:

- Objekti i administratës;
- Depo e grumbullimit të letrës dhe plastikës;
- Peshoja për matjen e materialit të grumbulluar nga letra dhe plastika;
- Ormani me tabelën komanduese të peshores;
- Rrethoja e lokacioni të depos,
- Platoja funksionale, rrugët dhe hapësira për parkim,
- Sipërfaqet e gjelbëruara.

3.1. Potencialet ekzistuese

Njëri nga elementet kyçë të hulumtimi i gjendjes ekzistuese të mjedisit është hulumtimi i potencialit ekzistues, e që konsiston në analizën e mirëfilltë të tërësisë hapësinore në zonën më të gjer të depos, me qëllim që në bazë të pasojave të njohura të vlerësohen mundësitë e rrezikut ekologjik dhe në bazë të tyre të rekomandohen masat për zvogëlimin ose edhe eliminimin e tyre. Karakteristikat e potencialit ekologjik përbëhen nga kombinimi i ndikimeve të ndërsjella të faktorëve natyror si janë toka, uji, ajri reliefi, flora dhe fauna. Çdo njëra nga potencialet

ekologjike në këtë mënyrë posedon funksione të caktuara, që në esencë kanë rëndësi të dorës së parë analizën e problematikës së tërësishme të mbrojtjes së mjedisit.

Ndikimi i ndërsjellë i faktorëve të veçantë si dhe ndikimi i tyre në formimin e potencialit ekologjik dhe i funksioneve të tyre themelore me interes për analizën në fjalë, së bashku me kompleksin e marrëdhënieve të mundshme është kështu:

Faktorët natyrorë:

- Toka;
- Uji;
- Flora dhe
- Fauna.

Potencialet janë:

- Të tokës;
- Të ujit;
- Klimatike;
- Të biotopës;
- Për banim pushim dhe rekreacion.

Në bazë të përshkrimit të paraqitur më lartë është e qartë që faktorët natyror formojnë disa potenciale natyrore karakteristikat funksionale të të cilave duhen marr parasysh gjatë valorizimit të ndikimit të Depos së grumbullimit të letrës dhe plastikës me infrastrukturën përcjellëse e Kompanisë Roto Recycling SH.P.K., në hapësirën konkrete.

3.2. Pozita gjeografike e lokacionit

Lokacioni i Depos së grumbullimit të letrës dhe plastikës me infrastrukturën përcjellëse e Kompanisë Roto Recycling SH.P.K., gjendet në dalje të Obiliqit në drejtim të Prishtinës në anën e djathtë të rrugës dhe nuk ka objekte të afërta të banuara nga kjo zonë.

Kompania Roto Recycling SH.P.K është kompani private e grumbullimit të letrës dhe plastikës. Veprimtaria e kësaj ndërmarrje është grumbullimi i letrës dhe plastikës.

Kompania Roto Recycling SH.P.K, është e regjistruar në ARBK (Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve Kosovare), Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë me numër unik identifikues 812038281.

Kompania Roto Recycling SH.P.K me veprimtarinë, Depo e grumbullimit të letrës dhe plastikës, ndodhet ne parcelën me nr. P-72614055-01275-1, zona kadastrale Obiliq, Komuna e Obiliqit.

Lokacioni ku gjendet Depo e grumbullimit të letrës dhe plastikës shihet në pamjet si në vijim:



Komuna e Obiliqit



Pamja e Depos me Google Map

Depo e grumbullimit të letrës dhe plastikës gjendet në dalje të Obiliqit në anën e djathtë të rrugës Obiliq-Prishtinë.

Sipërfaqja ku është e ndërtuar Depo e grumbullimit të letrës dhe plastikës është një hapësirë me sipërfaqe të rrafshët, më herët kjo sipërfaqe ka qenë djerrinë, por në vitet e fundit për arsye të pozitës gjeografike, këto sipërfaqe dhe sipërfaqet tjera në rrethinë janë duke u shndërruar në zonë industriale për shkak të pozitës gjeografike që ndodhet lokacioni, për arsye se afër lokacionit ku gjendet depo kalon rruga që lidhet me rrugën magjistrale Prishtinë-Mitrovicë, Prishtinë-Ferizaj dhe gjendet afër autostradës Ibrahim Rugova dhe Arbër Xhaferri që e lidh me Shkupin dhe Tiranën.

Përgjatë rrugës janë ndërtuar dhe janë duke u ndërtuar objekte afariste, siç janë: pompa të derivateve të naftës, objekte tregtare dhe industriale, depo të materialeve ndërtimore etj. Në afërsi të ngastrave kadastrale ku është e ndërtuar Depo nuk ndodhen objekte të banimit por vetëm objekte afariste, siç i përmendëm më lartë.

Në bazë të gjitha analizave është krijuar mundësia për vlerësimin e përgjithshëm të gjendjes ekzistuese të mjedisit jetësor si dhe ndikimeve të mundshme negative gjatë aktivitetit të Depos për grumbullimin e letrës dhe plastikës.

Këto vlerësime shërbejnë si bazë për kuantifikimin e ndikimeve të mundshme dhe për përcaktimin e masave të nevojshme mbrojtëse duke marrë parasysh se kemi të bëjmë me Depon për grumbullimin e letrës dhe plastikës me potencial të vogël ndotës për mjedisin.

3.3. Popullsia dhe vendbanimet

Komuna e Obiliqit ka qenë territor i veçantë qysh gjatë kohës së sundimit turk. Diku nga viti 1873 njihet si qendër gjeostrategjike e Rrafshit të Kosovës. Me parë Obiliqi quhej Globoder. Në vitin 1912 emërohet Obiliq. Statusin e komunës e kishte gjithashtu pas Luftës së Parë dhe Luftës së Dytë Botërore, deri në vitin 1962, kur përfshihet në kuadër të komunës së Prishtinës. Më 27 nëntor 1989 prapë konstituohet si Komunë. Më 20.12.1999, me vendim të Këshillit Komunal, është formuar Komisioni për Emërtimin e Vendbanimeve, me të cilin vendim qyteti i Obiliqit emërohet në Kastriot.

Komuna e Obiliqit shtrihet në pjesën qendrore të Kosovës me një sipërfaqe prej 105 km².

Ka një pozitë të mirë gjeografike, kufizohet me komunën e Prishtinës, Fushë Kosovës, Drenasit, Vushtrrisë dhe Podujevës. Ka lidhje hekurudhore të rëndësishme me Mitrovicën dhe Shkupin.

Këtë sipërfaqe e përbën një relief i ndryshëm me teren malor, sipërfaqe fushore dhe të rrafshët me tokë pjellore. Pjesa qendrore shtrihet rreth lumit Sitnica, ndërsa pjesët tjera të reliefs në lindje shkojnë duke u ngritur në kodra e lugina të malit Qyqavica dhe në perëndim po ashtu në kodra e lugina (male të degëve të maleve të Albanikut (Kopaonikut).

Rrjedhë se 75% e sipërfaqes së Komunës është sipërfaqe e rrafshët dhe kodrinore, ndërsa diku rreth 25% janë terrene malore. Pika më e lartë e territorit të komunës është në fshatin Kozaricë me 740 m lartësi mbidetare, kurse pika më e ulët është tek ura në mes të fshatit Palaj dhe qytetit të Obiliqit me 530 m lartësi mbidetare.

Bartës të zhvillimit ekonomik në komunën e Obiliqit janë termoelektranat, minierat e thëngjillit, toka bujqësore e kategorisë I-IV dhe rruga magjistrale M2 në relacionin Prishtinë–Mitrovicë. Komuna e Obiliqit ishte një ndër qendrat më të mëdha të zhvillimit ekonomik në Kosovë në kohën e ish Jugosllavisë. Tani kjo komunë trashëgon të gjitha potencialet që ishin dikur, sigurisht jo në gjendjen funksionale të atëhershme. Kjo do të thotë që përveç përparësisë që ofron kjo trashëgimi kryesisht industriale, ka edhe problemet e veta në lidhje me nevojat për investime të mëdha, për ndërrimin e teknologjisë, për specializimin e punëtorëve, për mos ndotjen e ambientit dhe hapjen e mihjeve të reja, me pasojë të zhvendosjes së fshatrave. Edhe sot barrën e zhvillimit të energjisë elektrike në Kosovë e mban komuna e Obiliqit.

3.4. Infrastruktura ekzistuese

Depoja për grumbullimin e letres dhe plastikës gjendet afër lokacionit ku kalon rruga që lidhet me rrugën magjistrale Prishtinë-Mitrovicë, Prishtinë-Ferizaj dhe gjendet afër autostradës Ibrahim Rugova dhe Arbër Xhaferri që e lidh me Shkupin dhe Tiranën.

Furnizimi me ujë dhe energji elektrike është në përgjithësi i mirë, përveç ndërprerjeve të rralla. Përderisa lidhjet e telefonisë fikse janë në gjendje të mirë, shfrytëzimi i telefonisë mobile është është gjithashtu i mirë.

Në komunën e Obiliqit, aktiviteti ekonomik me numrin më të madh të të punësuarve është në njësitë e Termocentralit Kosova A dhe Kosova B, si subjekte shoqërive aksionare (SHA), kurse sa i përket biznesit privat ai kryesisht zhvillohet në formë të dyqaneve të vogla tregtare dhe zejtare me një numër të vogël të të punësuarve.

Komuna e Obiliqit është një ndër komunat më të ndotura në Kosovë e ndoshta edhe në Evropë. Burimet kryesore të ndotjes së mjedisit janë kapacitetet e vjetruara dhe teknologjia e vjetër për prodhimin e energjisë elektrike, siç janë termoelektranat Kosova A dhe Kosova B, ngrohtorja, tertorja. Gjatë prodhimit të energjisë elektrike vjen deri te djegia e thëngjillit, me ç' rast lirohen gazrat dhe pluhuri fluturues në formë të tymit dhe nëpërmjet të tymtarëve lirohen në atmosferë, ndërsa elementet tjera, të cilat janë në përbërje të thëngjillit lirohen në formë të hirit dhe nëpërmjet të ujërave shkarkues, pas proceseve teknologjike.

Është një Komunë e pasur me ujë, ka tre lumenj jo të mëdhenj: Llapi, Drenica, Sitnica si dhe sistemin e ujitjes Ibër-Lepenc. Sitnica rrjedh nëpër terren fushor me një pjerrtësi mesatare 0,7 m/km. Një dukuri mjaft e dëmshme është edhe ndotja e vazhdueshme e këtyre lumenjve.

Komuna e Obiliqit përveç që ka sipërfaqe me rezerva të mëdha të thëngjillit, ka edhe një sipërfaqe të rrafshët dhe mjaft pjellore prej 5400 ha, prej tyre 900 ha janë pronë shoqërore, kurse 4500 ha janë në pronësi private. Komuna ka diku rreth dy hektarë sera, të shpërndara nëpër fshatrat e komunës. Si orientim i zhvillimit të bujqësisë do të jenë kryesisht agrikultura (plantacionet, vreshtat, bletaria etj.) dhe agrobiznesi d.m.th. finalizimi i produkteve bujqësore që kultivohen.

3.5. Kushtet klimatike

Klima e kësaj treve sipas pozitës së saj gjeografike, lartësisë mbi detare dhe sipas hulumtimeve meteorologjike siç janë: reshjet dhe temperaturat mesatare mujore dhe vjetore, është klimë kontinentale. Territori ku është e ndërtuar Depoja kryesisht ka klimë kontinentale që karakterizohet me vera të nxehta dhe dimra të ftohta (edhe pse viteve të fundit ka ndryshime të ndjeshme klimatike për shkak ndryshimeve globale klimatike).

Sa i përket reshjeve dhe temperaturave, Pranvera dhe Vjeshta karakterizohen përfaqësisht me klimë të njëjtë. Të reshurat janë të formës riguese ose me karakter lokal. Temperatura mesatare sillet prej 10.1°C gjer 10.7°C e si mesatare e këtyre merret temperatura prej 10.4°C. Temperaturat më të larta janë në muajin qershor 35,6°C, ndërsa në korrik 32,4°C dhe në gusht

31,1°C. Temperaturat më të ulëta janë në muajin dhjetor janar dhe shkurt. Temperaturat maksimale mesatare vjetore janë 22,5°C, ndërsa temperaturat mesatare minimale sillen prej (-1.7) - (-3.4)°C.

Regjimi i reshjeve në komunën e Obiliqit ka karakterin e klimës aride. Shuma e përgjithshme e reshjeve sillet nga 499 mm deri 675 mm. Vlera mesatare vjetore e lagështisë relative është 76.8 %. Muaji më i thatë është gushti 66.2%, kurse më me lagështi janë nëntori dhe dhjetori 84.2%. Në komunën e Obiliqit erërat më të shpeshta janë ato veriore me 26%₀ dhe më të rrallat janë ato jug – perëndimore me 27 %₀ kurse shpejtësia mesatare më e madhe e erës është 2.2 m/sek.

3.6. Gjendja Hidrologjike

Në territorin e Komunës së Obiliqit ekzistojnë tre lumenj natyror që janë: Sitnica, Drenica dhe Llapi si dhe kanalin artificial Ibër-Lepenci, i cili vjen nga liqeni i Ujmanit, liqe akumulues në lumin Ibër. Lumi Sitnicës përshkon territorin e Komunës nga jugu në veri dhe përfaqëson 80 % të ujërave, derdhet në lumin Ibër. Lumi Drenica rrjedhë në perëndim dhe i bashkëngjitet lumit Sitnicë e bashke me te derdhet në Ibër. Lumi Llap rrjedhë në lindje, edhe ky derdhet në Sitnicë. Lumi i Sitnicës gjatë stinës së verës ka prurje 2.5m³/s kurse gjatë stinës dimrit, prurja është 15 herë më e madhe.

Depo e grumbullimit të letrës dhe plastikës gjendet në një distancë të largët nga lumenjtë në Komunën e Obiliqit.

3.7. Flora dhe Fauna

Ndikimi i Depos për grumbullimin e letrës dhe plastikës në domenin e florës dhe faunës paraqet dukuri që kërkon shqyrtim të kujdesshëm, në kuptim të evidentimit të pasojave të ndryshme të mundshme negative dhe zvogëlimit të tyre brenda kufijve të pranueshëm. Ajo që dallon florën dhe faunën e këtij regjioni janë ndryshimet intensive si pasojë e veprimtarisë së njeriut.

Problematika e gjendjes ekzistuese të llojeve bimore nuk është në masë të mjaftueshme për të sjell përfundime meritorë. Në ngastrën ku është Depo e grumbullimit të letrës dhe plastikës ka bimësi e cila është karakteristike për këtë lartësi mbidetare, shkurre të bimë barishtore me zhvillim të ulët dhe djerrina për shkak të përbërjes së dheut dhe ndotjes nga Termocentralet Kosova A dhe Kosova B. Pyjet e këtij regjioni kryesisht janë pyje të llojit gjethor dhe përbëjnë një numër të madh të llojeve, si që janë bingu, qarri etj. me rritje të ulëta dhe mesatare. Në bazë të shqyrtimeve vizuale në rrethinë të zonës kur realizohet projekti, kemi hasur në bimësi që karakterizohet kryesisht nga bimët e ulëta barishtore posaçërisht bar të egër, kultura periodike bujqësore, si dhe të gjitha pemët frutore, thana, gështenja, lajthia, arra, molla, dardha

etj. Në bazë të dhënave zyrtare të Institutit për mbrojtjen e natyrës, nuk ekzistojnë të dhëna se në këtë teren kemi të bëjmë me ndonjë hapësirë të mbrojtur me ligj në drejtim të biodiversitetit dhe natyrës në përgjithësi. Bazuar në florën ekzistuese dhe kushtet klimatike të rajonit, e duke marr për bazë edhe të dhënat nga banorët si dhe densitetin e banorëve, në këtë zonë jetojnë gjitarët, zvarranikët, brejtësit, insektet e ndryshme, lepuri i egër, dhelpra, ujku, derri i egër iriqi etj. Prej brejtësve jetojnë mijtë, prej zvarranikëve gjarpri, breshkat e tokës zhapini i gjelbër, insektet krahëfortë, krahëlusporë, mizat etj., ndërsa prej shpezëve janë karakteristike zogjtë, bilbilat, thëllëza e fushës, sorrat, shqiponja, etj.

Duke marrë parasysh karakteristikat e gjendjes ekzistuese mund të konstatohet se në lokacionin e këtij regjioni nuk ka potenciale të shprehura të vegjetacionit të cilat mund të rrezikohen me funksionalizimin e Depos për grumbullimin e letrës dhe plastikës.

3.8. Karakteristikat sizmike

Sizmikja mikro-regjionale e këtij lokacioni dallohet me mundësi të dridhjeve të tokës të intensitetit prej 6-7 shkallë të Merkalit. Sipas hartave sizmike të regjionit, hapësira e gjerë e hulumtuar nuk i përket një intensiteti të njëjtë të dridhjeve sepse varet nga karakteristikat gjeologjike të tokës, thellësisë së ujërave nëntokësore etj.

Sizmiteti i terrenit paraqet parametër me interes në vete për analizën e ndikimeve të mundshme në fushën studimore të mjedisit.

Sipas hartave sizmike, hapësira e gjerë e hulumtuar i takon intensiteteve të ndryshme reversibile që do të paraqiten në tabelën në vijim.

Tabela - Intensiteti sizmologjik i regjionit të hulumtuar të shkallës MSK-64

Periudha kthyesë e seizmitetit (vjet)	Shkalla
50	V dhe VII
100	VII, VIII dhe IX
200	VIII dhe IX
500	VIII dhe IX
1000	VIII dhe IX

3.9. Efektet vizuale (peizazhi)

Karakteristikat e peizazhit të tërësisë së analizuar hapësinore paraqesin njërin nga elementet për të perceptuar marrëdhëniet e tërësishme në relacionin e Depos së grumbullimit të letrës dhe plastikës -mjedisi. Me këtë rast gjithsesi duhet marr parasysh se bëhet fjalë për një kategori psikologjike efektive e cila manifestohet përmes veprimit të tërësishëm sinergjik të rrethinës në shikuesin, ku medoemos janë të pranishme implikimet kulturologjike, sociologjike dhe subjektive .

Lokacioni ku gjendet Depo për grumbullimin e letrës dhe plastikës, në hyrje në parcelë-ngastër e deri në fund të ngastrës është i rrafshët me një disnivel shumë të vogël në drejtim të termocentralit (J-L). Efektet vizuale (peizazhet) janë kriteriume me rëndësi në ruajtjen e mjedisit dhe nëse nuk zgjidhen drejt konsiderohen si degradim i mjedisit.

Depo e grumbullimit të letrës dhe plastikës nuk ka ndonjë ndikim negativ në prishjen e peizazhit në lokacionin e analizuar, prandaj nuk ndikon në shikuesin.

3.10. Ajri

Termocentralet e Korporatës Energjetike të Kosovës, njihen si ndotësitë më të mëdhenj të ajrit, të vendosura në komunën e Obiliqit. Për obiliqasit nuk ka ajër të pastër as gjatë stinës së dimrit e as gjatës stinëve tjera.

Nga pamjet e përditshme në Obiliq shihet se si tymi dhe hiri që dalin nga Termocentrali Kosova A dhe Kosova B, shkaktojnë ndotje tejet të lartë të ajrit.

Ata që vuajnë më së shumti nga pasojat e këtyre termocentraleve që mundësojnë furnizimin me energji të gjithë Kosovës, janë pa dyshim banorët e Obiliqit dhe komunat për rreth.

Edhe pse u punua në ndërrimin e pajisjeve për filtrim, ndotja e ajrit mori përmasa shqetësuese në Obiliq dhe në qytetet përreth ku përqendrimi i grimcave në ajër ishte 10 deri në 16 herë më i lartë sesa vlerat që lejohen nga Organizata Botërore e Shëndetësisë dhe legjislacioni në fuqi për mjedis.

Lagështia relative ajrit oscilon gjatë vitit dhe është në raport të kundërt me temperaturat e ajrit. Të dhënat tregojnë vlerë mesatare vjetore rreth 77%.

Lagështia më e ulët është në muajin prill, kurse ajo më e larta është në muajin dhjetorë.

3.11. Uji

Komuna e Obiliqit është një nga Komunat më të ngarkuara me ndotje në Kosovë jo vetëm të ujërave por edhe ajrit dhe tokës. Sitnica përveç ndotjes nga KEK-u është e ngarkuar edhe me ujërat e zeza të pa trajtuara të qytetit të Prishtinës dhe të banorëve të Komunës së Obiliqit.

Gjithashtu në lumin Llap dhe Drenica shkarkohen ujërat e zeza të fshatrave që gravitojnë në afërsi të tyre.

Me një fjalë ujërat e Komunës së Obiliqit janë në gjendje të mjerueshme, si ato sipërfaqësore edhe ato nëntokësore.

4. PËRSHKRIMI I DEPOS PËR GRUMBULLIMIN LETRËS DHE PLASTIKËS

4.1 Përshkrimi i procesit të grumbullimit të letrës dhe plastikës

4.1.1. Grumbullimi i letrës

Hapi i parë në grumbullimin e letrës është ndarja në burim. Individët, bizneset dhe institucionet e ndryshme inkurajohen të ndajnë mbetjet e letrës nga llojet e tjera të mbetjeve në momentin e krijimit, hedhjes së tyre. Kjo mund të bëhet përmes përdorimit të koshave të veçantë për letër, duke e bërë më të lehtë mbledhjen grumbullimin dhe riciklimin.

Shumë komunitete ofrojnë shërbime për grumbullimin e materialeve të riciklueshme, duke përfshirë letrën. Banorët pajisen me kosha ose kontejner të dedikuara për letër dhe kamionët për grumbullim i marrin rregullisht këto materiale nga vendgrumbullimet, duke i transportuar në Depo dhe pastaj i përgatiten për riciklim.

Koshat e grumbullimit të letrës vendosen në mënyrë strategjike në zona publike, biznese dhe institucione për të lehtësuar mbledhjen dhe grumbullimin e letrës. Për më tepër, qendrat e grumbullimit iu mundësojnë individëve të sjellin letrën e tyre të riciklueshme direkt në një vend qendror, duke inkurajuar pjesëmarrjen e komunitetit në procesin e grumbullimit dhe pastaj riciklimit të saj.

Bizneset, zyrat dhe industritë luajnë gjithashtu një rol të rëndësishëm në mbledhjen e letrës. Ato miratojnë programe të brendshme riciklimi, duke inkurajuar punonjësit të ndajnë mbetjet e letrës, duke bashkëpunuar me kompani për grumbullimin dhe përpunimin e rregullt të sasive të mëdha të letrës.

Shërbimet e copëtimit të letrës janë thelbësore për asgjësimin e sigurt të dokumenteve të ndjeshme. Shumë prej këtyre shërbimeve kanë gjithashtu mekanizma për të mbledhur dhe ricikluar letrën e copëtuar, duke siguruar që edhe dokumentet konfidenciale të kontribuojnë në rrjedhën e riciklimit.

Pasi të mblidhet, letra transportohet në depo e pastaj me automjete transporti iu transportohet kompanive të riciklimit. Kamionët që e presojnë letrën ose shërbimet e dedikuara të transportit e

çojnë letrën në depo, e cila është e pajisur me makineritë e nevojshme për klasifikim, pastrim dhe paketim.

Promovimi i një kulture të grumbullimit të përgjegjshëm të letrës është thelbësor për maksimizimin e përfitimeve të riciklimit dhe minimizimin e ndikimit mjedisor të prodhimit të letrës. Duke marrë pjesë në përpjekjet për mbledhjen e letrës, individët dhe organizatat kontribuojnë në ruajtjen e pyjeve, mbrojtjen e mjedisit, reduktimin e konsumit të energjisë dhe mirëqenien e përgjithshme të planetit.

Shumë ndërmarrje tregtare dhe prodhuese e përdorin letrën për paketimin e produkteve të tyre, për ti ruajtur të njëjtat gjatë transportit dhe deponimit të tyre. Kjo letër, pasi që është kryer misioni i transportit dhe deponimit, kur produkti qitet në raftet e shitjes, largohet nga paketimi dhe në këtë mënyrë letra e cila është përdorur për paketim, grumbullohet.

Pasi është bërë grumbullimi i letrës në kosha të caktuar, lënda veçohet nga materialet e tjera, si plastika, qelqi apo mbeturina të tjera. Pas këtij procesi, materiali dërgohet në qendrën e grumbullimit, Depo, mbledhet në stoqe, e më pas, transportohet sipas kontratave të ndryshme deri te përdoruesit, ricikluesit e sajë.



Letra e Grumbulluar

Letra që përdoret për gazeta është e klasifikuar me cilësi shumë të dobët, ndërsa letra që përdoret për printer, është e cilësisë më të mirë. Cilësia e letrës përcaktohet nga gjatësia e fibrës, e cila ndryshon përmasë pas çdo procesi të cilit i nënshtrohet.

Pasi i bëhet riciklimi 5 deri në 7 herë, gjatësia e fibrës shkurtohet, e si pasojë, nuk do të kemi material të mjaftueshëm për të përgatitur letër të re. Për rrjedhojë, do të na duhet ta miksojmë me material shtesë fibër.



Letra e presuar, e gatshme për transport

4.2.2. Grumbullimi i plastikës

Hapi i parë në grumbullimin e plastikës është ndarja në burim. Individët, bizneset dhe institucionet inkurajohen të ndajnë mbetjet e plastikës nga llojet e tjera të mbetjeve në momentin e krijimit, hedhjes së tyre. Kjo mund të bëhet përmes përdorimit të koshave të veçantë për plastikë, duke e bërë më të lehtë mbledhjen dhe pastaj riciklimin e sajë.

Shumë komunitete ofrojnë shërbime për grumbullimin e materialeve të riciklueshme, duke përfshirë plastikën. Banorët pajisen me kosha ose kontejner të dedikuara për plastikë dhe kamionët riciklim i marrin rregullisht këto materiale nga vendgrumbullimet, duke i transportuar në Depo dhe pastaj për riciklim.

Koshat e riciklimit vendosen në mënyrë strategjike në zona publike, biznese dhe institucione për të lehtësuar mbledhjen e plastikës. Për më tepër, qendrat e lëshimit të riciklimit iu mundësojnë individëve të sjellin plastikën e tyre të riciklueshme direkt në një vend qendror, duke inkurajuar pjesëmarrjen e komunitetit në procesin e riciklimit.

Bizneset, zyrat dhe industrinë luajnë gjithashtu një rol të rëndësishëm në mbledhjen e plastikës. Ato miratojnë programe të brendshme riciklimi, duke inkurajuar punonjësit të ndajnë mbetjet e plastikës, duke bashkëpunuar me kompani riciklimi për grumbullimin dhe përpunimin e rregullt të sasive të mëdha të plastikës.

Pasi të mblidhet, plastika transportohet në depo, presohet dhe pastaj iu transportohet kompanive të riciklimit. Kamionët e riciklimit ose shërbimet e dedikuara të transportit e çojnë plastikën në depo, e pajisur me makineritë e nevojshme për klasifikim, pastrim dhe paketim.

Promovimi i një kulture të grumbullimit të përgjegjshëm të plastikës është thelbësor për maksimizimin e përfitimeve të riciklimit dhe minimizimin e ndikimit mjedisor të prodhimit të plastikës. Duke marrë pjesë në përpjekjet për mbledhjen e plastikës, individët dhe organizatat kontribuojnë në ruajtjen e pyjeve, ruajtjen e mjedisit, reduktimin e konsumit të energjisë dhe mirëqenien e përgjithshme të planetit.



Grumbullimi i plastikës



Presimi i plastikës



Depoja e grumbullimit të letrës dhe plastikës

4.2 Përshkrimi i pajisjeve

Pajisjet për grumbullimin e letrës dhe plastikës luajnë një rol kyç në sigurimin e një sistemi efikas dhe të qëndrueshëm të mbledhjes dhe grumbullimit të këtyre materialeve. Pajisjet themelore për grumbullimin e letrës dhe plastikës janë:

Koshat dhe Kontejnerët

Sigurimi i koshave dhe kontejnerëve të qëndrueshëm dhe të madhësisë së përshtatshme për mbledhjen e letrës dhe plastikës. Çdo kontejner duhet të ketë etiketa të qarta për të udhëzuar përdoruesit në hedhjen e duhur të mbeturinave.



Stacionet ndarëse

Sigurimi i stacioneve ndarëse për të lehtësuar ndarjen e letrës dhe plastikës. Këto stacione mund të përfshijnë shirita transportues ose tavolina ku individët mund të bëjnë ndarjen efikase.



Kamion për mbledhjen e mbeturinave

Siguroni kamionë mbledhës me seksione të veçanta për ndarjen e letrës dhe plastikës. Këto kamionë duhet të jenë të pajisura me hidraulikë për ngarkim dhe shkarkim të lehtë.



Presha dhe paketuese të letrës dhe plastikës

Presha dhe paketuese të letrës dhe plastikës për të zvogëluar vëllimin e letrës dhe plastikës së mbledhura, duke zvogëluar volumin për transportim dhe deponim. Këto pajisje ndihmojnë në optimizimin e hapësirës dhe efikasitetit të transportit.



Makina grirëse

Përmes makinave grirëse e përmirësojmë proceset e riciklimit. Grirja e letrës dhe plastikës ndihmon në krijimin e paketimeve më dendësi më të madhe, volum më të vogël dhe siguron integritet të mirë të materialit gjatë riciklimit.



Pajisje Sigurie

Pajisje sigurie të përshtatshme, duke përfshirë doreza, xhaketa sigurie dhe syze mbrojtëse. Siguria është e rëndësishme kur trajtohen materiale potencialisht të rrezikshme si plastika dhe letra.



Shenjat edukative

Përdorimi i shenjave informuese për të edukuar publikun rreth mënyrës së duhur të hedhjes së letres dhe plastikës. Udhëzimet e qarta ndihmojnë në zvogëlimin e kontaminimit dhe përmirësojnë cilësinë e materialeve të grumbulluara.



Peshoret

Peshoret shërbejnë për të matur saktësisht sasi të letrës dhe plastikës të mbledhur. Këto të dhëna janë të rëndësishme për ndjekjen e normave të riciklimit dhe optimizimin e rrugëve të grumbullimit.



4.3. Platoja

Platoja e Depos së grumbullimit të letrës dhe plastikës në Obiliq, është e ndërtuar ashtu që pjerrtësia është e përshtatshme për përcjelljen ujërave sipërfaqësore, dhe e përshtatshme për shkarkimin, ngarkimin dhe bartjen e materialit të Depos si lëndë e parë dhe si dhe produktit të gatshëm.

4.4. Rezervarët

Në lokacionin e Depos së grumbullimit të letrës dhe plastikës në Obiliq nuk kemi ndonjë rezervarë.

4.5. Karakteristikat kryesore të procesit teknologjik në Depo

Procesi teknologjik i grumbullimit të letrës dhe plastikës ka disa karakteristika kryesore që ndihmojnë në përmirësimin e efikasitetit dhe cilësisë së këtij procesi. Këto karakteristika përfshijnë:

Automatizimi

Përdorimi i teknologjisë automatizuese ndihmon në shpejtimin e procesit të grumbullimit. Pajisjet automatikë dhe sensorët e automatizuar mund të ndihmojnë në ndarjen dhe procesimin e shpejtë të letrës dhe plastikës.

Ndarja efikase

Teknologjitë e ndarjes së avancuara, si shpërndarja me sensorë ose teknologjia e klasifikimit me ajr, ndihmojnë në ndarjen e efikase dhe të saktë të letrës dhe plastikës. Kjo përmirëson cilësinë e materialeve të grumbulluara.

Presimi dhe paketimi

Përdorimi i presave dhe paketueseve kontribuon në zvogëlimin e volumit të letrës dhe plastikës për transportim dhe depo. Përthithja e materialeve në bala ose blloqe bën procesin më efikas dhe ekonomik.

Siguria e punëtorëve

Në ambiente të automatizuara, siguria e punonjësve mbetet një karakteristikë e rëndësishme. Pajisjet duhet të jenë të dizajnuara për të minimizuar rreziqet dhe për të ofruar mjete mbrojtëse për personelin.

Optimizimi i rrjedhës së punës

Procesi teknologjik duhet të jetë i dizajnuar me kujdes për të optimizuar rrjedhën e punës dhe për të zvogëluar kohën e nevojshme për grumbullimin, ndarjen dhe përpunimin e letrës dhe plastikës.

Këto karakteristika përbëjnë një pjesë të rëndësishme të një sistemi të avancuar të grumbullimit të letrës dhe plastikës, duke përmirësuar cilësinë e riciklimit dhe duke promovuar një mjedis më të qëndrueshëm.

4.6. Komponentët hyrëse të procesit të grumbullimit të letrës dhe plastikës

Procesi teknologjik i grumbullimit të letrës dhe plastikës ka disa komponentë hyrëse kyçe që ndihmojnë në fillimin dhe funksionimin e këtij procesi. Këta komponentë përfshijnë:

Pikat e Grumbullimit

Pikat e grumbullimit janë vendet ku individët mund të hedhin letrën dhe plastikën e tyre. Këto mund të jenë kontejnerë në rrugë, ambiente të përcaktuara në ndërtesa ose pika të tjera të dedikuara për mbledhjen e këtyre materialeve.

Koshat dhe Kontejnerë për Mbledhjen e Mbeturinave

Koshët dhe kontejnerët janë pajisjet themelore ku njerëzit hedhin letrën dhe plastikën. Këto duhet të jenë të dizajnuara për të lehtësuar shpërndarjen dhe mbledhjen e materialeve pa kontaminim.

Teknologji e Ndarjes Automatike të letrës dhe plastikës

Pajisjet e ndarjes automatike ndihmojnë në ndarjen e letrës dhe plastikës në pikat e grumbullimit. Këto mund të përfshijnë konveyorë me sensorë dhe teknologji tjetër që ndihmon në ndarjen efikase të materialeve.

Pajisjet e Përpunimit dhe Presimi

Presat janë pjesë të rëndësishme të procesit. Ato përpunojnë letrën në pjesë më të vogla, ndërsa presat shtypin dhe formojnë blloqe të plastikës dhe letrës për të zvogëluar volumin.

Sistemet e Kontrollit dhe Monitorimit

Pajisjet dhe sistemet e kontrollit dhe monitorimit ndihmojnë në ndjekjen e procesit të grumbullimit. Këto mund të përfshijnë sensor, kamera dhe teknologji të tjera për të siguruar një operacion të rregullt dhe efikas.

Kontejnerët dhe Kamionët

Kontejnerët janë të dizajnuar për të ruajtur materialet e grumbulluara, ndërsa kamionët e mbledhjes janë të përgjegjshëm për të transportuar materialet nga pikat e grumbullimit në qendrat e përpunimit.

4.7. Komponentët dalëse në procesin teknologjik

Komponentët dalës (ose rezultatet) të procesit teknologjik të grumbullimit të letrës dhe plastikës janë fazat përfundimtare të këtij procesi, ku materialet janë përpunuar dhe përgatitur për të dërguar në fazat e mëtejshme të riciklimit. Këto komponentë dalëse përfshijnë:

Bloqet e letrës dhe plastikës

Pas fazës së presimit dhe përpunimit, materialet e grumbulluara formësohen në blloqe. Këto mund të jenë blloqe të letrës dhe plastikës të papërpunuara, të cilat janë të përgatitura për transportim dhe riciklim më tej.

Materiale të presuara të përgatitura për transportim

Procesi dalës përfshin përgatitjen e materialeve për transportim. Bloqet janë të dizajnuara për të zvogëluar volumin dhe peshën e materialeve për të lehtësuar transportimin.

Transporti në qendrat e riciklimit

Pas formimit të blloqeve, materialet nga letra dhe plastika transportohen në qendrat e riciklimit. Kjo mund të bëhet përmes kamionëve të special të mbledhjes ose nga operatorët e shërbimeve të grumbullimit.

Përmes këtyre komponenteve dalëse, procesi teknologjik i grumbullimit të letrës dhe plastikës ka një ndikim të drejtpërdrejtë në mjedis duke zvogëluar ndotjen, përdorimin e burimeve të natyrshme dhe kontribuar në qëndrueshmërinë e mjedisit.

Këto komponentë dalëse janë thelbësore për të shënuar suksesin e një sistemi të grumbullimit të letrës dhe plastikës, pasi ato tregojnë se materiale të ricikluara janë përpunuar dhe përdorur përsëri në mënyrë të qëndrueshme dhe efikase.

5. VLERËSIMI I NDIKIMIT NË MJEDIS

Analiza e vlerësimit të gjendjes ekzistuese të mjedisit si dhe vlerësim i ndikimeve të mundshme të cilat janë si pasojë e proceseve (veprimeve) që zhvillohen në Deponë të grumbullimit të letrës dhe plastikës, tregojnë se deri te kuantifikimi i të dhënave mund të arrihet sipas një analize gjithëpërfshirëse. Të gjitha ndikimet e mundshme nuk janë të vlerave të njëjta që të bëhet edhe kuantifikimi i tyre. Gjatë punës kontinuele në Depo, vije deri te rritja e emisionit të materieve ndotëse grimcore gjatë procesit të grimcimit, presimit dhe gjatë transportit me kamion si dhe gjatë ngarkimit dhe shkarkimit të mbetjeve nga letra dhe plastika. Gjithashtu nga puna e automjeteve tjera që manipulojnë nëpër platonë të Depos, avullimi i karburanteve të lëngëta, krijohet zhurmë nga motorët e pajisjeve në Depo, në mënyrë

indirekte mund të vije deri te ndotja e ujërave sipërfaqësore dhe sipërfaqeve të dheut afër Depos.

5.1. Ndotja e ajrit

Gjatë funksionimit kontinuel në kompleksin e Depos, vije deri te rritja e ndotjes së ajrit nga emisioni i grimcave të letrës dhe plastikës si dhe gazrave dhe avullimi i karburanteve të lëndës djegëse dhe vajrave që përdoren për lubrifikimin e pajisjeve të cilat përmbajnë një numër të madh të komponentëve ndotëse me koncentrim të ndryshme por më të shprehur dhe më me ndikim në ndotje të ajrit janë CO, NO_x, H_x, SO₂ dhe Pb edhe pse në sasi shumë të vogël.

Ndikimi i tyre në shkallën e ndotjes varet para së gjithash nga kushtet klimatike dhe meteorologjike dhe gjendjes teknike të pajisjeve në Depo, duke përfshirë pajisjet për depluhim të vendosura në pajisjet grimcuese dhe presuese.

Ndotja e ajrit mund te vije edhe nga:

- Pluhurat të cilët lirohen gjatë transportit të fraksioneve ne të gjithë shiritat transportues të letrës dhe plastikës;
- Pluhurat të cilët lirohen nga mekanizmi ngarkues i fraksioneve në automjetet transportuese të letrës dhe plastikës;
- Gazrat të cilat lirohen nga automjetet e transportit dhe ngarkimit;
- Emisioni i pluhurit te gazrave gjate transportimit te mbeturinave nga letra dhe plastika;
- Nga procesi teknologjik për grumbullim, ndarje, grimcimin dhe presimin e mbetjeve nga letra dhe plastika nga ku lirohen grimcat e letrës dhe plastikës, grimcat e pluhurave të cilat gravitojnë për shkak të peshës së tyre në drejtim të tokës dhe depozitohen në afërsi të Depos. Këto grimca kanë përbërje të elementeve kimike që posedon letra dhe plastika, pluhurat të cilat i bartë ajri për shkak të reliefit dhe kushteve tjera mjedisore gravitojnë në distanca ma të largëta, kjo situatë e përshkruar, kishte me qenë pa përdorimin e masave për zvogëlimin e pluhurit, edhe pse sasia e këtyre grimcave është e vogël në Depo.
- Ndotja e ajrit vjen edhe gjatë lirimit të pluhurit gjatë zbrazjes së letrës dhe plastikës nga kamionët në Depo.
- Ndotja e ajrit vjen edhe gjatë lirimit të gazrave nga automjetet e transportit dhe automjeteve tjera që nevojiten për realizimin e procesit teknologjik për grumbullimin, transportimin, sortimin, grimcimin, presimin dhe transportin e letrës dhe të plastikës.

5.2. Ndotja e ujit

Rreziku më potencial për ndotjen e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore si dhe ndotja e dheut është nëse vije deri të shpërthimi e rezervarit me karburant të automjeteve, gjë e cila ka gjasa shumë, shumë të vogla. Pastaj edhe gjatë funksionimit kontinuel të kompleksit të Depos në sipërfaqet shërbyese për komunikacionin mund të vije deri te sedimentimi i grimcave të pluhurit dhe materieve ndotëse që janë si rezultat i fundërrimit nga gazrat e djegura motorike i fshirjes së gomave të automjetit i rrjedhjes së derivateve dhe vajrave nga pajisjet e Depos dhe i fundërrimeve nga atmosfera etj.

Vlerat më të larta të ndotjes së ujërave nga sipërfaqet shërbyese të Depos pritet të jenë gjatë sezoneve të dimrit kur kemi të reshura më të mëdha dhe shpëlarje më të madhe. Përqendrimet e ndotësve të sedimentuar në platon e Depos drejtpërdrejt varet nga zgjatja e periodave të thata dhe pa shi dhe nga sasia e pluhurit në Depo. Përqendrimi i grimcave të suspenduara është proporcional me sasinë e ujërave nga shpëlarja apo nga të reshurat atmosferike, para shpëlarjes së sipërfaqes së platosë nga personeli apo nga të reshurat atmosferike.

Ndikime negative në ujë shkaktohen nga :

- Mundësia e derdhjes aksidentale e derivateve, vajrave dhe yndyrave (lyrësit) e ndryshme të cilat derdhen në tokë nga makinat transportuese dhe makinat tjera të cekura në pasuset e më sipërm me derdhjen e tyre në tokë ndikojnë në ndotjen e ujërave sipërfaqësore me rastin e të reshurave atmosferike si dhe ndotjen e ujërave nëntokësore;
- Nga derdhja e ujërave të zeza, nyjat sanitare në Depo;

Nga mbeturinat metalike të korroduara të cilat depozitohen në hapësirat e Depos dhe nga mbeturinat tjera të ndryshme, etj.

5.3. Ndotja e tokës

Toka (dheu) si element themelor natyror është një sistem i përbërë ekologjik i cili nga veprimet e ndryshme mund të vije deri te degradimi i vlerave themelore karakteristike të saja. Në aspektin e ndotjes së dheut në fazën e shfrytëzimit të Depos ndotja e dheut është si pasojë e sedimentimit të ndotjeve që sjellin përmes ujërave sipërfaqësore që vijnë nga sipërfaqja e platosë së Depos dhe me fundërrimin e komponentëve ndotëse nga ajri, kjo ndotje njihet si ndotje sistematike e dheut gjatë funksionimit të Depos pastaj kemi edhe ndotjen aksidentale të dheut e cila vije si pasojë e avarive të pajisjeve. Këto ndotje të dheut evitohen vetëm me largimin e dheut të kontaminuar dhe transportimin e tij në vendet e caktuara aty ku nuk rrezikojnë mjedisin. Nga këto të dhëna

vërehet se ndotja e tokës (dheut) afër Depos varet para së gjithash nga rrjedhja e ujërave të ndotura nga sipërfaqja e platosë së Depos, konfiguracioni i terrenit dhe nga sedimentimi i ndotjeve prej ajrit në hapësirat e Depos.

5.4. Zhurma

Në domenin e mbrojtjes së mjedisit zhurma paraqet një faktor me rëndësi hapësinore e cila ka ndikim të madh në dëmtimin e të dëgjuarit, në sistemin nervor, në hipertension në koncentrim të njeriut në punë etj.

Gjatë fazës së punës në Depon e grumbullimit të letrës dhe plastikës vije deri te ngritja e përkohshme e zhurmës nga:

- Funkcionimi i automjeteve transportues të letrës dhe plastikës;
- Automjeteve që përdoren për nevojat e Depos;
- Nga puna e pajisjeve për grimcim dhe presim;
- Etj.

Lokacioni ku është Depo e grumbullimit të letrës dhe plastikës, është i ekspozuar zhurmës së krijuar nga zhurma e pajisjeve, që janë pjesë e procesit teknologjik të procesimit të mbetjeve nga letra dhe plastika. Sipas gjendjes faktike të kompleksit të Depos në lokacionin e analizuar mund të konstatojmë se niveli zhurmës i shprehur në dB është nën vlerën e lejuar prej 60 dB.

5.5. Ndikimet në florë dhe faunë

Sipas analizave të bëra deri tani në lidhje me ndotjen e ajrit, ujit dhe tokës mund të vije deri te ndikimet në florë dhe faunë mirëpo sipas gjendjes faktike në teren respektivisht në lokacionin e caktuar nuk do të kemi zhdukje të vegjetacionit pos nga sipërfaqet nën objekte dhe në platonë e Depos kjo do të thotë se kemi të bëjmë me koncentrim të vogël të ndotësve.

E njëjta do të vlente edhe për faunën që do të thotë se nuk pritet të ketë ndikime negative, bile nëpër hapësirat e objektit vërehet një vegjetacion i vrullshëm me drunjë dhe bimësi të llojllojshme.

5.6. Ndikimi në mjedis në rastet aksidentale

Ndikimet në raste aksidentale mund të jenë si rrjedhojë e ndonjë dështimi të pajisjeve të Depos se grumbullimit të letrës dhe plastikës dhe përbërjes kimike të letrës dhe plastikës dhe ndodhjes

së zjarrit. Dështimi i këtyre pajisjeve mund të qonte deri te lëndimi i punëtorëve dhe ndotja e mjedisit.

Situata aksidentale që mund të ndikojë në ndotjen mjedisore nga Depo është edhe shfaqja e zjarrit apo nga ndonjë rrjedhje aksidentale.

Zjarri gjate fazës së ndërtimit dhe aktiviteti punës të Depos se grumbullimit të letrës dhe plastikës mund të shkaktohet nga:

- Përdorimi i flakëve të hapura;
- Përdorimi i pajisjeve të saldimit, bocave të lëndës djegëse për saldim etj.
- Nga rrjedhjet e ndryshme të lëndëve djegëse dhe lubrifikuese;
- Nga mekanizmi punues (mundësia e ndezjes);
- Nga mekanizmi punues mundësia e pëlcitjes së gypave hidraulik;
- Nga aksidentet e mundshme ne komunikacion gjatë transportit të letrës dhe plastikës;
- Etj..

6. MARRJA E MASAVE PËR PARANDALIMIN DHE ZVOGËLIMIN E NDIKIMEVE

6.1. Masat e ndërmarra për eliminimi i ndikimeve të dëmshme në mjedis

Sipas analizës së bërë mbi ndikimin e Depos në mjedis, si dhe në bazë të vlerësimit të lokacionit ku është e vendosur Depo e grumbullimit të letrës dhe plastikës, ku në bazë të projektit kryesor të ndërtimit dhe rekomandimeve të dhëna në këtë raport, depo me veprimtarinë kontinuele të saj në lokacionin e analizuar sipas këtij raporti nuk rrezikon mjedisin sepse janë realizuar shumë nga parakushtet e nevojshme për mbrojtjen adekuate të mjedisit, por me gjithë atë duhet të parashihet së në rast se vije deri te ndotja duhet të ndërmerren masat për parandalimin apo zvogëlimin e ndikimeve negative që shpijnë deri te rrezikimi i mjedisit jetësor në kufij të pranueshëm.


Me qëllim të zvogëlimin të mëtejshëm të ndikimeve potenciale negative në mjedis, rekomandohet ndërmarrja e masave të cilat bëjnë pjesë në domenin e menaxhimit të rrezikut në rrethanat e jashtëzakonshme dhe të rregullta në përputhje me ISO 45001:2018, Occupational Health&Safety Management System dhe implementimi i ISO 14001:2015, Environmental management systems.

6.2. Masat mbrojtëse të ujërave

Edhe pse në Depon e grumbullimit të letrës dhe plastikës nuk zhvillohen procese që gjenerojnë ndotje serioze të ujërave sipërfaqësore, e pastaj e dheut ujërave nëntokësore, por ndotja ndodh si që e kemi përshkruar ne pasuset e mësipërme. Në Depo duhet te jete ne funksion sistemi për grumbullimin dhe bartjen e ujërave të ndotura nga sipërfaqet manipulative dhe të dërgohen në

gropën sedimentuese për ndarjen e derivateve dhe vajrave nga ujërat e ndotura. Duhet të ndërtohet seperatori që përmes mureve në disnivele (kaskada) të bën ndarjen (seperimin) e derivateve dhe vajrave nga ujërat të ndotura dhe i deponon në pusëtën e posaçme, ku pas mbushjes së pusëtës duhet të pastrohet nga ndërmarrjet e licencuara për pastrimin e seperatorëve. Seperatori duhet të përmbush kriteret teknike që janë të parapara me rregullore dhe normativa në fuqi. Duhet të ndërtohet gropa septike për trajtimin e ujërave të zeza e pastaj pas gropës septike ujërat e trajtuara të dërgohen në bunarin filtrues. Ujërat e trajtuara në separator dërgohen në bunarin filtrues.

Ujërat nga seperatori nuk guxojnë të lëshohen në recipient apo të derdhen në natyrë pa u trajtuar nëse përmbajnë derivate mbi 1mg/l dhe materie të suspenduara mbi 30mg/L në ujë.



Përpos masave të përshkruara më lartë për mbrojtjen e mjedisit nga ndikimet negative të mundshme të përshkruara në pasuset e mësipërme investitori duhet të i ndërmer edhe këto masa:

- Për mbrojtjen e tokës nga ndikimet negative hapësirat operationale të mbulohen me beton ose asfalt;
- Furnizimi me ujë si dhe për nevoja tjera që shfrytëzohen për larjen e platos manipuluese, për ujitje të sipërfaqeve gjelbëruese, për pajisjet për zjarrfikje bëhet nga rezervuari i ujit i cili është i lidhur me sistemin e ujësjellësit të KRU Prishtina;
- Të gjitha ujërat atmosferike dhe ujërat e përdorura nga sipërfaqet me ndikim të mundshëm duhet të grumbullohen me kolektor dhe nëpërmjet gypave të përcjellën në separator;
- Ujërat fekale nga nyjat sanitare përmes gypave duhet të dërgohen në gropën septike;

- Duhet rregullisht të bëhet kontrollimi i seperatorit pas mbushjes duhet bërë pastrimin e tij, fundërrina dhe vaji duhet të deponohen në enë të posaçme dhe pastaj të dërgohen në trajtim të mëtejshëm sipas ligjit për trajtimin e materieve të rrezikshme.
- Duhet të vendoset kontejneri adekuat i pajisur me kapak për deponimin e mbeturinave komunale, pas mbushjes së tij duhet të dërgohet për zbrazje në deponin regjionale;
- Duhet të vendosen enët adekuate për deponimin e mbeturinave të lëngëta;
- Duhet të bëhet mbjellja e sipërfaqeve dhe oazave të pa betonuara dhe asfaltuara me barë dhe drunjë dekorativ me qëllim të pastrimit të ajrit nga ndotjet me gazra, dhe për çështje vizuale.

6.3. Masat për mbrojtjen e ajrit

Qëllimi i hartimit të VNM-së, pra është përcaktimi i ndotjeve të mundshme në mjedis i Depos se grumbullimit të letrës dhe plastikës dhe ndërmarrja e masave për mbrojtjen e mjedisit rrethues.

Për të parandaluar dhe zvogëluar sasinë e ndikimeve negative në ajër gjatë fazës së zhvillimit të aktiviteteve grumbulluese në Depo, kompania:

- Do të bëhet mirëmbajtja e rregullt e pajisjeve të procesit të prodhimit të cilat edhe do të jenë burim i emisioneve të pluhurit;
- Do të bëhet mirëmbajtja e rregullt e pajisjeve dhe sistemit të ventilimit në Depo;
- Do të bëhet kontrollimi i rregullt i sistemit të ventilimit dhe do të ndërmerren masat e duhura;
- Në hapësirat e objektit të Depos se grumbullimit të letrës dhe plastikës me qëllim të eliminimit të kundërmimeve të ndryshme do të vendoset sistemi i ventilimit të hapësirës së hallës prodhuese, prandaj në njërin anë të murit do të vendosën ventilatorët me filtra për pastrimin e ajrit, kurse në anën tjetër të murit do të vendosen hapjet për hyrjen e sasisë së ajrit të pastër aq sa është nxjerrë me anë të ventilatorëve, gjithashtu aroma e pakëndshme do të zvogëlohet përmes ajrimit përmes dritareve të vendosura në objekt;
- Do të bëhet kontrollimi i rregullt i pajisjeve dhe sistemit të ventilimit ashtu që pjesët e dëmtuara të ndërrohen. Në kushtet e udhëheqjes së procesit të prodhimit sipas standardeve të projektimit dhe me kontroll të mirëfilltë të pajisjeve për filtrim nuk ekziston rreziku që ndotja e ajrit të jetë mbi vlerat maksimale të lejuara të materieve ndotëse të caktuara si pas Udhëzimit Administrativ (QRK) Nr. 07/2021 për rregullat dhe normat e shkarkimeve në ajër nga burimet e palëvizshme të ndotjes;
- Do të bëjë matjen e cilësisë së ajrit, vlerat e fituara do të krahasohen dhe nuk guxojnë të jenë më të larta se vlerat e caktuara si pas Udhëzimit Administrativ Nr. 07/2021 mbi

rregullat dhe normat e shkarkimeve ne ajër nga burimet e palëvizshme të ndotjes. Vlerat e fituara ne bazë të matjeve do të dorëzohen ne Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, intervali i matjeve do të kryhet ne bazë të përcaktimit me aktet ligjore dhe ne bazë të marrëveshjes me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

6.4. Masat për mbrojtjen e tokës

Për të parandaluar dhe zvogëluar sasinë e ndikimeve negative në tokë gjatë fazës së aktiviteteve prodhuese në Depos se grumbullimit të letrës dhe plastikës, mbetjet do të grumbullohen dhe pastaj do të iu jepen kompanive qe mbledhin mbeturinat në përputhje me ligjet në fuqi.

Mbetjet e ngurta komunale nga punonjësit e Depos do të hidhen në kontejnerë dhe të merren nga kompania kompetente e shërbimeve komunale në vendin e saj depozitave. Trajtimi i mbeturinave komunale i nënshtrohet Ligjit për menaxhimin e mbeturinave. Mbetjet nga procesi i prodhimit do të grumbullohen në qese dhe mund të hidhen në kontejnerët e depozitimit të mbeturinave komunale.

Në rastin kur kemi ndonjë avari dhe kemi ndotje të dheut, sasia e dheut të kontaminuar largohet dhe dërgohet në depo apo vende speciale, ndërsa sasia e njëjtë e dheut plotësohet me dhe të përshtatshëm për atë pjesë të ambientit.

6.5. Masat për mbrojtje kundër zjarri

Depo e grumbullimit të letrës dhe plastikës do te merr masa parandaluese në rast të ndonjë zjarri këto masa:

- Për shuarjen e zjarrit të përdoren aparatet mobile zjarrfikëse që duhet të vendosen në vendet ku do të jenë më efikase;
- Do të vendosen dy aparate mobile zjarrfikëse të tipit (S9) dhe sipas nevojës;
- Në rastet kur kemi rrjedhje të vajrave dhe lubrifikanteve, atëherë vendi ku janë derdhur do të pastrohet me absorbues kimik apo me ashkla të imta druri të cilat me lopata mblidhen dhe futen në fuqi ku mbahen në depo deri sa të merën nga kompanitë e licencuara për trajtimin e tyre;
- Duhet kontrolluar rregullisht korrektësinë e instalimeve elektrike;
- Duhet kontrolluar dhe monitoruar ambienti i kompleksit te Depos ;
- Evakuimi i personave të cenueshëm nga objektet;
- Të mëren masat e sigurisë kundër vënies së qëllimshme të zjarreve.

6.6. Masat e mbrojtjes nga zhurma

Në Depon e grumbullimit të letrës dhe plastikës do të bëhen matjet e zhurmës në përputhje me ligjet dhe rregullat mbi mbrojtjen nga zhurma. Matjet duhet bërë në afërsi të objekteve të banimit. Për vlerësimin e rezultateve të fituara nga matjet duhet ti krahasojmë me vlerat e lejuara me standardet dhe rregulloret në Republikën e Kosovës.

Në raste se zhurma e mesit nga matjet tejkalon at të lejuarën atëherë do të merren të gjitha masat që niveli i zhurmës të zvogëlohet në nivelin e lejuar sipas rregullave në fuqi. Në varësi nga fazat e procesit të punës duhet edhe të punësuarit në ato vende të punës të përdorin mjetet kundër zhurmës (kufje).

Zhurma e gjeneruar gjatë procesit të grumbullimit duhet të jetë në kufijtë e lejueshëm në përputhje Ligjin Nr. 02/L-102 për mbrojtjen nga zhurma). Sipas kësaj zgjidhjeje vendndodhja në fjalë është e vendosur në një zonë banimi.

Nivelet e lejueshme të zhurmës për një zonë banimi janë:

- Zhurma ditore (7-19 orë) 55 dB;
- Zhurma e mbrëmjes (19-23 orë) 55 dB;
- Zhurma e natës (23-7 orë) 45 dB.

Zhvilluesi i projektit duhet të bëjë zvogëlimin e zhurmës kur konstatohet se niveli i sajë është rritur mbi kufijtë e lejuar. Zvogëlimi i nivelit të zhurmës duhet të bëhet duke zëvendësuar pjesët individuale përgjatë vijës së procesit teknologjik ose duke vendosur barriera specifike në vende me nivele të rritura të zhurmës, ose nga zhvendosje të makinave që lëshojnë zhurmë mbi nivelin e lejuar, edhe pse në depo kjo nuk parashihet të ndodhë.

6.7. Ndikimet në raste të aksidenteve mjedisore - në rast zjarrit

Në rast të aksidenteve mjedisore-zjarri do të bëhet evakuimi i detyrueshëm i personave në rrezik nga ndërtesa ku ka ndodhur zjarri kritike për të siguruar objektivin themelor të mbrojtjes së njerëzve dhe ndërtesës nga zjarri. Ndodhja aksidentale e zjarrit shkakton një situatë mjaft stresuese dhe shpesh reagimi i njerëzve është i paparashikueshëm. Për dallim nga çdo ditë duke e lënë objektin në përdorim normal, do të ketë evakuim të detyruar në rast se një zjarr ndodh papritur, në rast të pa mundësisë së parashikimit të tij. Elementet si paniku, i cili është i pranishëm në situata të tilla, vetëm e vështirëson evakuimin.

Procedurat e evakuimit në rast zjarri:

- Të sigurojë evakuimin e sigurt të personave të cënueshëm dhe pajisjeve të vlefshme;
- Shuarja dhe lokalizimi i zjarrit dhe ruajtja e integritetit dhe stabilitetit të objektit.

Parandalimi i zjarrit në objektin e Depos do të zbatohet në mënyrë më efektive nga aplikimi i materialeve jo të djegshme në elemente strukturorë kudo që të jenë të mundura. Në këtë drejtim, duhet të bëhet zëvendësimi i materialit që është më lehtë i ndezshëm ose ka një fuqi termike më të lartë, me një material që ka një temperaturë më të lartë të ndezjes dhe që prodhon më pak energji termike.

Nëse zjarri nuk arrin të shuhet me pajisje "S" ose "CO₂", në raste të tilla nevojitet me shumë kontroll dhe nevojitet me shumë ndërhyrje dhe me këtë rast duhet të përfshihen me shume njerëz me më shumë pajisje, pra duhet të kërkohet ndihmë. Pas kësaj mund të fillojë me evakuimi, duke pasur parasysh që një numër personash nuk janë kompetent për ndërhyrje kundra zjarrit, dhe në shumë raste ata pengohen nga paniku i tyre në ndërhyrje. Për të siguruar evakuimin efikas është i nevojshëm të sigurojë integritetin e strukturës në komunikimet rrugore dhe ambientin karakteristikat nën faktorin e rrezikut në kohën e evakuimit. Gjithsesi kompanisë i kërkohet hartimi i planit të emergjencave e me këtë edhe planin (projektin) sipas legjislacionit në fuqi kundra zjarrit.

6.8. Masat për mbrojtjen e florës dhe faunës

Sipas analizave të bëra deri tani në lidhje me ndotjen e ajrit, ujit dhe tokës mundë të vije deri te ndikimet në florë dhe faunë por ato janë shumë të pakta.

Mirëpo sipas gjendjes faktike në teren respektivisht në lokacionin e caktuar nuk do të kemi zhdukje të vegjetacionit pos nga sipërfaqet manipulative, nga sipërfaqja nën pajisjet e Depos, do të thotë se kemi të bëjmë me përqendrim të vogël të polutantëve. E njëjta do të vrente edhe për faunën që do të thotë se nuk pritet të ketë ndikime negative. Kompania nuk duhet të deponoj pa kontroll mbeturina në vende të ndryshme por ato duhen të deponohen në vende me destinacion të caktuar. Për të parandaluar dhe zvogëluar sasinë e ndikimeve negative në ajër gjatë fazës të zhvillimit të aktiviteteve grumbulluese në Depo në raste të paraqitjes së zjarrit menjëherë duhet të merren masa për neutralizimin e tij në mënyrë që të mos dëmtohet bota bimore. Pajisjet kundër zjarrit duhen të ruhen në mënyrë të veçantë. Për mbrojtjen e botës shtazore kompania do të tregoj kujdes duke kufizuar lëvizjet e të punësuarve jashtë zonës operuese dhe të kenë kujdes në nivelin e zhurmës, cilësinë e ajrit, ujit etj.

6.9. Masat e marra për mbrojtjen nga rreziqet aksidentale

Depo e grumbullimit të letrës dhe plastikës do të përgatis planin e intervenimit për raste të aksidenteve ekologjike:

- Do të përgatitet plani i mbrojtjeve nga zjarri sipas legjislacionit në fuqi për emergjenca;

- Oborri i Depos do të thuret me tel gjembor;
- Do të merren të gjitha masat për evitimin e derdhjes së derivateve të naftës dhe vajit nga makinat transportuese dhe ngarkuese si dhe pajisjet tjera;
- Do të merren të gjitha masat e sigurisë për kyçjen e automjeteve transportuese në rrugë pa penguar komunikacionin;
- Do të merren të gjitha masat e sigurisë konform ligjit për siguri në punë, mbrojtje të shëndetit të punësuarve dhe mjedisit të punës. Përdorim i drejt, mbikëqyrje e rregullt dhe mirë mbajtje e pajisjeve.
- Rregullorja ku janë të definuara procedurat për rastet aksidentale,
- Aftësimi i të punësuarve dhe obligimet e tyre në situata aksidentale.
- Sistemi i pajisjeve kundër zjarrit me anë të ujit dhe aparatet me mjete kimike si dhe enët me rërë.
- Në mënyrë permanente të mirëmbahet ambienti në kompleksin e Depos e posaçërisht nyjat sanitare, platoja me rrethin dhe ambienti rrethues;
- Janë në dispozicion pajisjet doracake kundër shkëndijave ;

Rekomandimet tjera për evitimin e ndikimeve negative

- Mbikëqyrje e rregullt dhe menaxhim i mirë gjatë punës;
- Ndalohet ndezja e mbeturinave të lëngëta dhe të ngurta brenda lokacionit;
- Rregullorja ku janë definuar procedurat për rastet aksidentale;
- Aftësimi i të punësuarve dhe obligimet e tyre në situata aksidentale.

Në mënyrë permanente mirëmbahet mjedisi në kompleksin e Depos së grumbullimit të letrës dhe plastikës.

7. PROGRAMI I MONITORIMIT

Ndikimet direkt nga aktiviteti i Depos së grumbullimit të letrës dhe plastikës, bazuar në vlerësimet e ndikimit në mjedis janë ndikimet në tokë, ajër dhe ujë.

Këto ndikime do të jenë minimale në mjedis pas marrjes së masave për zvogëlimin e këtyre ndikimeve, dhe si të tilla mund të monitorohen dhe të mbahen nën kontroll. Për këtë arsye parashihet një program monitorues për të gjitha shkarkimet.

Monitorimi i ajrit dhe ujit duhet të bëhet me marrjen e mostrave nga ekspertët e kompanisë dhe kryerjen e analizave në institute adekuate dhe të raportohen në MMPHI sipas kërkesës së tyre.

8. RAPORTIMI

Do të kryhet nga menaxhmenti, gjegjësisht nga ekspertët e kompanisë së paku në fund të çdo viti kalendarik, ku do ti paraqiten të dhënat relevante nga të gjitha monitorimet e bëra brenda vitit, të cilat do të raportohen autoriteteve përkatëse sipas kërkesës së tyre dhe komunitetit lokal brenda komunës.

9. MARRJA E MASAVE REHABILITUESE PAS PËRFUNDIMIT TË AKTIVITETIT GRUMBULLUES

Objektivat e rikultivimit

Pas përfundimit të shfrytëzimit dhe përfundimit të jetëgjatësisë së Depos se grumbullimit të letrës dhe plastikës, varet nga pronari se a do të vazhdojë me këtë projekt apo do të përfundojë aktivitetin grumbullues. Pas këtij afati të gjitha pajisjet duhet të çmontohen dhe të vendosen në lokacionin tjetër apo në bazë të leverdisë së kompanisë të shiten si material i vjetruar, kurse pjesët metalike dhe objektet ndihmëse të demoloohen dhe dërgohen në deponi regjionale.

Nga proceset teknologjike do të krijohen substrate që i takojnë kategorisë së tokave të dëmtuara d.m.th. substrate të papërshtatshme (sterile) për rikultivim.

Duhet të bëhet mbushja e hapësirës së krijuar nga shfrytëzimi, për mbushjen e kësaj hapësire dhe kthimin e tyre në gjendje të përafërt me mjedisin rrethues dhe nga ngastra që do të jenë të përshtatshme për rikultivim.

Rikultivimi i sipërfaqeve të shfrytëzuara duhet të kryhet edhe gjatë shfrytëzimit d.m.th. mbushjen në të njëjtën kohë të sipërfaqeve të shfrytëzuara.

Zgjedhja e modelit të rikultivimit varet nga: qëllimi i rikultivimit i cili nënkupton që gjatë procesit të shfrytëzimit dhe pas përfundimit të shfrytëzimit, sipërfaqet e degraduara, prapë të kthehen në funksionin e saj primar dhe kështu zvogëlohet ndikimi negativ i këtij projekti në ekosistem.

Për të qen rikultivimi sa më i suksesshëm duhet të kryhen këto faza të procesit të rikultivimit:

- Rikultivimi teknik
- Rikultivimi agroteknik dhe
- Rikultivimi biologjik

Me rikultivimin teknik do të krijohet profil i ri i tokës, e cila mund të përdoret për nevoja tjera si psh. për mbjelljen e fidanëve të ndryshme (pemëve) frytdhënëse apo edhe mbjelljen me të lashtat bujqësore.

Për formimin e shtresë së sipërme sipërfaqësore produktive të tokë parashihet shtresimi i shtrese të dheut deri 50 cm.

Pas fazës së rikultivimit teknik fillon faza e rikultivimit agroteknik e cila fazë fillon me analizimin e substratit të krijuar për të përcaktuar vetitë agrokimike dhe pedologjike, ku pastaj në bazë të analizave propozohen masat agroteknike që do të aplikohen në këtë tokë të re.

Për të llogaritur numrin e fidanëve për tërë sipërfaqen që do të rikultivohet duhet të kalkulohet me distancën në mes rendeve dhe distancën në rend sipas relacionit:

$$N_f = S/axb$$

Ku:

N_f- numri i fidanëve;

S- paraqet sipërfaqen,

a- paraqet distancën në mes rendeve ,

b- paraqet distancën në mes fidanëve.

Qëllimi afatgjatë i rikultivimit biologjik është që të krijojmë ekosistem të ri në hapësirat e dëmtuara në të cilën do të krijohet baraspeshe relative e të gjitha elementit të ekosistemit siç janë: toka, flora, fauna dhe efekti ekonomik në prodhimtari bujqësore. Rikultivimi biologjik është faza përfundimtare me të cilën arrihet edhe qëllimi i rikultivimit.

Rikultivimi i ngastrave të shfrytëzuara do të kryhet në marrëveshje dhe mbikëqyrje të inspektorëve të pushtetit lokal dhe nga inspektorët e MMPHI-se.

10. KONKLUDIM

Depo e grumbullimit të letrës dhe plastikës, pas plotësimit të kushteve nga raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM-S) duhet të i plotëson konditat mjedisore të parapara me ligjet mjedisore;

Në raport janë paraparë të gjitha masat mbrojtëse efikase të mjedisit dhe reduktimin e rrezikut në rrezik real të pranueshëm dhe investitori duhet të i përmbahet këtyre masave;

Gjatë aktivitetit të Depos së grumbullimit të letrës dhe plastikës, duhet respektuar të gjitha masat mbrojtëse me ligjet në fuqi;

Duhet të sigurohet dhe të jenë në disponim pajisjet, doracak kundër shkëndijave;

Në mënyrë permanente të mirëmbahet nyja sanitare, platoja me rrethin dhe gjelbërimit rrethues.

11. PËRFUNDIMI

Ndikimi i punës së Depos se grumbullimit të letrës dhe plastikës në mjedis është në nivelin e vlerave të rekomanduara nga Ligji për Mbrojtjen në Mjedis.

Ndikimi në tokë, ajër është i vogël dhe si i tillë mund të menaxhohet, kurse ndikimi në ujë mund të kontrollohet dhe të monitorohet dhe të raportohet në fund të çdo viti kalendarik sipas kërkesës së Ministrisë.

- Pajisjet dhe mjetet kundër zjarrit duhet të jenë të testuara dhe brenda afatit teknik të përdorimit.
- Të gjitha pajisjet tjera të instaluara në Depon e grumbullimit të letrës dhe plastikës duhet të ekzistojë testi adekuat mbi përdorimin e tyre dhe mbrojtje në punë.
- Të përcillet akumulimi dhe largimi i ujërave të ndotura nga pusetat (gropat septike) por

nëse instalohet sistemi për pastrimin e ujërave të ndotura atëherë është e nevojshme që të përcillet cilësia e ujërave në dalje nga separatori apo fundërruesi-gropa sedimentuese.

Zbatimi i këtij raporti, rekomandimeve, për aktivitetin e Depos se grumbullimit të letrës dhe plastikës në këtë lokacion nuk ka potencial të rrezikimit të shëndetit të njerëzve, gjithashtu ndikimet në tokë, ujë, ajër dhe peizazh dhe është i menaxhueshëm pas identifikimit dhe zbatimit të të gjitha masave mbrojtëse të rekomanduara në këtë raport, mund të minimizohen në nivel të lakmueshëm e edhe të eliminohen.

Mendojmë se këto të dhëna janë të mjaftueshme dhe i mundësojnë MMPHI-se dhënien e mendimit për Pëlqimin Mjedisor.